

REPUBLIKA E KOSOVË

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -XII-TË ME RADHË E -VII- E RREGULLT E KUVENDIT TË
KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 29 TETOR 2020

Mbledhja është mbajtur në objektin e Qendrës Rinore në Vushtrri, duke filluar në orën 10:30.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Ali Januzi, Agron Perçuku, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Fatmire Saraçi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Faton Shabani, Fitim Halili, Gresa Muli, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rrustemi, Melihate Basholli-Latifi, Suzana Sylla, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Mungoi: Safet Idrizi.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës z. Xhafer Tahiri, nënkryetari i komunës z. Besim Muzaqi, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësuesit e KFOR-it dhe zyrtar tjerë kompetent komunal.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë të pranishëm 34 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrjen e vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Në fillim të mbledhjes z. Ismet Hajrizi dha betimin para kuvendit, duke u bërë anëtar i kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me të drejta të plota.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-në emër të grupit kuvendar të PDK-së, propozoi që të mbahet një minutë heshtje për të ndjerin Xhemajl Cecelia.

Kuvendi me një minutë heshtje nderoj jetën dhe veprën e artistë të njohur tashmë të ndjerë z.Xhemajl Cecelia.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit – adresoi shqetësimin e banorëve të lagjes “Zenovit” të fshatit Dumnice e Poshtme, për mungesë infrastrukture si : rrugë, trotuar, kanalizimi, ujit, ndriçimit publik. Ajo që është më së shumti shqetësuese është mungesa e ujësjellësit, pasi shtrirja e rrjetit të ujësjellësit ka filluar para tre viteve ku janë vendosur gypat dhe ka mbetur vetëm aktivizimi i tyre,

por ajo që është edhe më shqetësuese është se afër rrjetit të ujësjellësit është i shtrirë edhe kabllot e rrjetit kabllor të internetit të një tensioni shumë të lartë që paraqet një rrezik shumë të lartë për banorët e këtij fshati. Në këtë rast është e domosdoshme formimi i një komisioni adekuat për vlerësim dhe adresimin e marrjes së masave përkatëse për përmirësimin e infrastrukturës në këtë fshatë.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-ngriti shqetësimin qytetarë dhe të biznesit vushtrrias, lidhur me rrugën maxhistrale e cila po zgjerohet në drejtim të Prishtinës, ku parashihet që afër hyrjes së Vushtrrisë të ndërtohet një rrethrotullim, për të cilën ai kërkoi që ai mos të jetë i mbyllur dhe që mos të ketë ndërprerje të rrugës por të ketë kyçje direkte për në Vushtri. Lidhur me këtë ai kërkoi që të ngritet një komision i udhëhequr nga kryesuesi i kuvendit dhe me përbërje nga kryetari i komunës, dhe shefat e grupeve kuvendare, i cili do të zhvillonte takim me ministrin e Ministrisë së Infrastrukturës, dhe kështu që të kërkohet që Vushtrriasit të kenë kyçjen direkte në rrugën që vjen nga Prishtina.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së-paraqiti sqarime lidhur me çështje e ngritura nga anëtarë e kuvendit.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-për rrugën që vjen nga Prishtina në Vushtri, shembulli më i mirë është ai i kyçjes në fshatin Smrekonicë, ku vjen nga Mitrovica se si është kyçja për të ardhur në Vushtri, ku fare nuk ke nevojë të futesh në rrethrotullim sepse është kyçja direkte dhe këtë e kërkoi që të bëhet edhe në rrugën që vjen nga Prishtina, sepse kjo nuk është teori konspirative.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se diskutimi i parafolësit të tij është puro konspiracion, sepse projekti është që rruga të vazhdohet me katër korsi prej rrethit të “Emonës” e deri në fshatin Nadakoc dhe për këtë është e nënshkruar kontrata dhe rruga është e pa ndërprerë. Pastaj është një rreth që e kanë paraparë inxhinierët që duhet ndërtuar për të dal në bajpasin për kyçje në autostradë. Andaj vlerësoi se kjo që po diskutohet është çështje është puro konspiracion, për faktin se projekti është i qartë. Ai njoftoi se me ardhjen në pushtet të kësaj qeverie është bërë shpronësimi i të gjitha pronave që nga fshati Lummadh e deri tek fshati Gojbulë, në të cilat do të kaloj zgjerimi i rrugës. Për këto shpronësime Qeveria e Kosovës ka paraparë një kosto financiare prej 6,000.000 € dhe pasi të përfundoj ky proces do të intensifikohen punimet në rrugën zgjerimin e rrugës maxhistrale dhe mendohet që deri në verën e vitit të ardhshëm të përfundojnë punimet në këtë rrugë e cila do të jep mundësi zhvillimit të qytetit dhe do ta transformoj përgjithmonë Vushtrrinë.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-vlerësoi se duhet ë kemi kujdes se si po parashihen projektet, ashtu që ato mos të dalin keq më vonë, ai këmbënguli se kyçja e Vushtrrisë në këtë rrugë duhet të jetë e pandërprerë për ti mbrojtur bizneset sepse nëse veprohet ndryshe, dikush do të hap një biznese qoftë, pompë benzine apo market dhe qytetarët nuk do të kenë mundësi të futen fare në qytet.

Refik Maloku, drejtor i DSHP-së-paraqiti sqarime lidhur me çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-ceku se legjislacioni në fuqi përcakton se materialet e kuvendit dërgohen shtatë (7) ditë më herët tek anëtarët e kuvendit, dhe shtoj se pikat e sjella më vonë bie në kundërshtim me ligjin për shkak të mos respektimit të afati ligjor. Ai kërkoi nga qeveria që të sqaroj se cila është urgjenca për një procedim të tillë të këtyre pikave sepse nëse ka urgjencë atëherë është mirë të bisedohet dhe të gjendet një zgjidhje. Në të kundërtën e kësaj ai propozoi që gjitha këto materiale të procedura me vonesë të largohen nga rendi i ditës ashtu që të njëjta të shqyrtohen në njërin nga mbledhjet e ardhshme.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit- tha se sa i përket propozimit për plotësim ndryshimin e Statutit të Teatrit të Qytetit dhe kërkesës që të futet si pikë shtesë e propozuar për rend të ditës në mbledhjen

e sotme të kuvendit me duhet të sqaroj: Propozimi për ndryshimin e emrit të Teatrit të Qytetit ka ardhur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e cila drejtori udhëhiqet në mënyrë jo profesionale me këtë dikaster dhe nuk ka as udhëheqës adekuate profesionalë për të mirë menaxhuar këtë dikaster kjo është e para, dhe e dyta në këtë valë ka hy edhe kryetari pa e ditur, kuptuar e as pa pas shqisa të përcjelljes së ritmit të valles! Pyes çka po pretendohet me këtë propozim përveç politizimit të komunitetit artistik po edhe qytetarëve në përgjithësi, kujt do i duhet kjo qasje, kush do të përfitoj nga kjo, pse nuk keni ide zhvillimore e organizative por silleni si uzurpator, ndërroni qasje tërhiqe këtë propozim sepse dihet fati i uzurpatoreve dhe merruni me deblokimin e llogarive të Teatrit të Qytetit, alokoni mjetet financiare mos e leni në terr dhe mos u boni profittera të territ. Tani veç kemi edhe propozimin e Komunitetit Artistik të Qytetit të Vushtrrisë të cilët kanë propozuar që Teatri i Qytetit të ndryshoj emrin dhe të mbaj emrin e artistit, e aktorit të madh Xhemajl Cecelia! Kjo është sfiduese për ne, kjo nuk ka kuptim Teatri i Qytetit është dhe duhet të mbetet i Qytetarëve. Kryetar dhe qeveri komunale hapni horizontet e rinis dhe komunitetit artistik, lejoni dhe ndihmoni të riorganizohet Teatri i Qytetit, përkraheni rinin, qytetaret e komunitetin artistik konform obligimeve ligjore me mjetet financiare të planifikuara për Teatër të Qytetit mos bllokoni kjo është kërkesa ime. Në emër të grupit kuvendar kërkoj edhe nga grupet tjera kuvendare të mos e përkrahin futjen në rend dite të kësaj pike shtesë me këtë do të mbrojmë dinjtetin e Artistit të madh tani më të ndjerit Adem Mikullovcit sepse po ta dinte i ndjeri sa ishte gjallë se do të provohet të manipulohet me emrin e tij për qëllime e përfitime politike sot do ta kishim testamentin me shkrim me të cilin nuk do të pranonte të manipulohet emri i tij. Respekt jetës e veprës së Adem Mikullovcit!

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-tha se i vjen shumë keq për gjithë këto diskutime në dy mbledhjet e fundit, për një pikë e cila nuk është aspak politike, por që është shumë njerëzore. Mbledhjen e kaluar ka vërejtur shumë hezitim, kundërshtim e shumë fjalë të tjera sa i përket emërimit të teatrit të qytetit me emrin e Adem Mikullovcit i cili për fat të mirë ka rastisur që të jetë bashkëvendës i yni. Atë ditë kur u diskutua pati tendenca që të thuhet se Adem Mikullovcit nuk bërë asgjë për Vushtrrinë, dhe kështu u tentua që ti mohohet gjithë kontributi për pesëdhjetë vitet e teatrit sa ka luajtur, ja hodhët poshtë edhe ato katër dhjetë e pesë rolet kryesore të cilat i kishte para se të bëhej deputet i Lëvizjes Vetëvendosje. Duhet të mos harrohet fakti se Adem Mikullovcit nuk ka qenë vetëm deputet i LVV-së, por ai ka qenë deputet edhe në kohën e leximit të deklaratës kushtetuese të 2 korrikut 1990 dhe atëherë nuk ka ekzistuar Lëvizja Vetëvendosje, por ka ekzistuar Adem Mikullovcit kontributi i tij dhe dashuria e tij për atdheun. Andaj ajo kërkoi nga të gjitha grupet kuvendar që përtej përkatësive partiake ta shtyjnë përpara dhe ta aprovojnë këtë emër të teatrit.

Pas shqyrtimit të rendit të ditës kuvendi me 23 vota "për" 6 vota "kundër" 1 votë "abstenim" të tjerët nuk morën pjesë në votim, vendosi që të gjitha pikat shtesë të rendit të ditë të procedura me vonesë ti shtyj për mbledhjen e ardhshme.

Në fund të debatit për rendin e ditës, Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë me 28 vota "për" 1 votë "kundër" të tjerët nuk morën pjesë në votim aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 24 shtator 2020;
2. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Dhënien e Dekoratave në Komunën e Vushtrrisë **(shqyrtimi i dytë);**
3. Shqyrtimi i Draft-rregullores për realizimin e të drejtave, përkujdesjen, mbrojtjen dhe parandalimin e punëve të rënda për fëmijët **(shqyrtimi i parë);**
4. Shqyrtimi i Draft – Strategjisë komunale për komunikim 2021 – 2023 **(shqyrtimi i parë);**
5. Shqyrtimi i Udhëzuesit të përgjithshëm për pjesëmarrjen e qytetarëve - Draft-Planit të pjesëmarrjes qytetare –në nivel lokal **(shqyrtimi i dytë);**
6. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore për vitin 2019 të KRM “Uniteti” Sh. A. Mitrovicë;
7. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
8. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit;
9. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2019/2020 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2020/2021;
10. Shqyrtimi i Informatës lidhur me dhënien në shfrytëzim të tokave bujqësore;
11. Shqyrtimi i Informatës nëntëmujore lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive në DKRS;
12. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 24 shtator 2020;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 24 shtator 2020.

2. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Dhënien e Dekoratave në Komunën e Vushtrrisë **(shqyrtimi i dytë);**

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit-propozoi që tek çmimi “Krenaria e Sportit” të rritet vlera mjeteve të parapara dhe atë: tek sporti individual vlera e çmimit të rritet nga 1000 € në 2000 €, ndërsa tek sporti kolektiv (klubi sportiv) të rritet vlera nga 2000 € në 5000 €.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-propozoi që çmimi “krenaria e sportit” të futet pas çmimit “Hasan Prishtina” në renditej të nenit 4 paragrafi 1.6.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me 25 vota “për” të tjerët nuk morën pjesë në votim, aprovoi Rregulloren për Dhënien e Dekoratave në Komunën e Vushtrrisë.

3. Shqyrtimi i Draft-rregullores për realizimin e të drejtave, përkujdesjen, mbrojtjen dhe parandalimin e punëve të rënda për fëmijët **(shqyrtimi i parë);**

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Realizimin e të Drejtave, Përkujdesjen Mbrojtjen dhe Parandalimin e Punëve të Rënda për Fëmijët.

2. Diskutimi publik fillon nga data 30 tetor 2020 dhe zgjat deri më 26 nëntor 2020.

3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.

4. Obligohet komisioni komunal që si hartues i draft-rregullores në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet komisioni i sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin nëntor 2020.

5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

4. Shqyrtimi i Draft-Strategjisë komunale për komunikim 2021 – 2023 (shqyrtimi i parë);

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft- Strategjia komunale për komunikim 2021-2023.

2. Diskutimi publik fillon nga data 30 tetor 2020 dhe zgjat deri më 26 nëntor 2020.

3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.

4. Obligohet zyrtari për informim që si hartues i draft-strategjisë në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet zyrtari i sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-strategjisë në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin nëntor 2020.

5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

5. Shqyrtimi i Udhëzuesit të përgjithshëm për pjesëmarrjen e qytetarëve - Draft-Planit të pjesëmarrjes qytetare –në nivel lokal (**shqyrtimi i dytë**);

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet Udhëzuesi i përgjithshëm për pjesëmarrjen e qytetarëve - Planit të pjesëmarrjes qytetare –në nivel lokal.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Zyra për Komunikim me Publikun dhe drejtoritë komunale.

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

6. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore për vitin 2019 të KRM “Uniteti” Sh. A. Mitrovicë;

Refik Maloku, drejtor i DSHP-së-tha se gjatë viteve të fundit kemi pasur progres sa i përket menaxhimit të mbeturinave, dhe për këtë falënderoi menaxhmentin e ndërmarrjes KRM “Uniteti” Sh. A. Mitrovicë.

7. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” aprovoi Raportin nëntëmujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.

8. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit;

9. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2019/2020 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2020/2021;

10. Shqyrtimi i Informatës lidhur me dhënie në shfrytëzim të tokave bujqësore;

11. Shqyrtimi i Informatës nëntëmujore lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive në DKRS;


12. Të ndryshme.


Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-kërkoj informatë me shkrim nga zyra e kryetarit të komunës, lidhur me kontratën për hartimin e projekteve, se a ka përfunduar si procedurë apo është ende duke u zbatuar *kontrata për hartimin e projekteve*, kërkoj të dihet vlera e projekteve të përfunduar deri më tash, pagesat dhe punë që janë ekzekutuar sipas projekteve që janë proceduar sipas Drejtorisë së Prokurimit. Po ashtu kërkoj informatë nga Drejtoria e Prokurimit se cilat prej

aktiviteteve të prokurimit kanë shkuar sipas projekteve, dhe që kanë qenë në bazë të kompanisë që kanë qenë përfituese të tenderit.

Mbledhja përfundoi në ora 11:10.

Bastri Duraku

Procesmbajtës

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit

